

Pyetje dhe Përgjigje për procesin e aplikimit

Nr. i Referencës së Thirrjes: SB ALB CG 02/23

Pyetja 1: A mund të aplikojnë organizatat jofitimprurëse që kanë aktualisht një projekt në zbatim të mbështetur nga Smart Balkan?

Po, të gjitha organizatat që janë aktualisht duke zbatuar një projekt të financuar nga SMART Balkans kanë të drejtë të aplikojnë në këtë thirrje publike për Grante Themelore. Gjithsesi është e rëndësishme të mbahet në konsideratë që një organizatë mund të zbatojë në të njëjtën kohë maksimumi dy grante të financuara nga SMART Balkans.

Pyetja 2: Kohëzgjatja/afati i aplikimit prej 24 muajsh është i detyrueshëm apo mund të jetë edhe më pak?

Granti Themelor siguron një mbështetje financiare për organizatat për një periudhë prej 24 muajsh.

Pyetja 3: Sa duhet të jetë përqindja që zënë pagat në të gjithë buxhetin vjetor të organizatës?

Projekti SMART Bankas nuk ka përqindje të përcaktuara për zërat e buxhetit operacional, por është shumë e rëndësishme që të mbahet në vëmendje që shpenzimet e parashikuara duhet të jenë të qarta dhe realiste.

Pyetja 4: A njihet TVSH-ja si shpenzim nga Smart Balkans?

Po TVSH është një shpenzim i njohur nga SMART Balkans.

Pyetja 5: Në shtojcën 3 (buxheti), planifikimi duhet të bëhet për 1 vit pasi në udhezim sqarohet që duhet të jetë deri në 24 muaj (2 vite)?

Mbështetja financiare nëpërmjet Grantit Themelor është për një periudhë prej 24 muajsh, ndërsa operativ i dorëzuar për aplikim duhet të jetë vetëm për vitin 2024.

Pyetja 6: A duhen përfshirë shpenzimet e degëve të organizatës në buxhet? Ne rastet kur ojf-ja ka degë në qytetet e tjera duhet të përfshihen në buxhet?

Formati i aplikimit përfshin buxhetin vjetor operativ të organizatës për vitin 2024 dhe nëse organizata ka degë lokale dhe shpenzime të planifikuara për zyrat lokale, këto shpenzime duhet të përfshihen në buxhetin e dorëzuar për aplikim.

Pyetja 7: Format i buxhetit nuk ka një ndarje se cilat zëra janë të mbuluar dhe cilat zëra kërkojnë financim nga Smart Balkans. Si kuptohet nga vlerësuesit se cilat zëra kërkojnë financim nga Smart Balkans?

Po është e vërtetë, formati i buxhetit nuk ka ndarje se për cilat zëra është siguruar aktualisht financim dhe cilat janë linjat buxhetore për të cilat organizata është në kërkim të financimit. Formatu i buxhetit ka vetëm ndarje për shumën totale dhe përqindjen për të cilën është siguruar financim deri në momentin e dorëzimit të aplikimit.

Pyetja 8: A duhet të përfshihen në buxhet projektet për të cilat organizata ka aplikuar për vitin 2024 për të cilat janë ende në pritje të përgjigjes nga donatorët nëse janë miratuar?

Po organizata duhet të përfshijë në buxhet të gjitha aktivitetet që planifikon të zbatojë gjatë vitit 2024 edhe nëse aktualisht nuk ka siguruar financim ose është në pritje të përgjigjes për financim nga donatorë të tjerë.

Pyetja 9: Aplikimi duhet të jetë në nivel organizativ apo mund të jetë edhe për një njësi brenda organizatës të cilën organizata synon ta fuqizojë?

Aplikimi duhet të bëhet në nivel organizate.

Pyetja 10: Kemi kryer aplikimin online GMP dhe nuk kemi marrë asnjë email konfirmues. A duhet të aplikoj edhe një herë tjetër apo duhet të pres?

Pocesi i regjistrimit të organizave në Platformën e Menaxhimit të Granteve nuk është automatik dhe ju do të merrni përgjigje nëse aplikimi juaj është aprovuar apo kërkohet informacion shtesë, brenda një jave nga momenti i aplikimit.

Pyetja 11: Sipas thirrjes grantet i referohen organizatave që veprojnë në fushat e Sigurisë dhe Stabilitetit ose Qeverisjes. Organizatat që punojnë në fushën e ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit mund të aplikojnë?

Po organizatat që ushtojnë aktivitetin e tyre në fushën e mbrojtjes së mjedisit mund të aplikojnë në këtë thirrje për aplikim.

Pyetja 12: Kur një organizatë është e themeluar dhe operon në Shqipëri, por gjithashtu i është bashkuar edhe rrjetit të organizatave të ngjashme profesionale ndërkombëtarisht a përbën kriter skualifikues fakti që është e përfshirë në këtë rrjet organizatash? (Organizata në Shqipëri nuk është filial, por pjesë e rrjetit).

Nëse organizata është e regjistruar sipas legjislacionit në fuqi si organizatë lokale dhe jo degë e një organizate ndërkombëtare, ajo mund të aplikojë në këtë thirrje publike. Pjesëmarrja në rrjete organizatash kombëtare dhe ndërkombëtrae nuk është një kriter përjashtues.

Pyetja 13: Financimi 30,000 Euro - 100,000 Euro i referohet vlerës së buxhetit me të cilin do të aplikohet apo mbështetjes që do të ofrohet?

Organizata do të aplikojë me buxhetin operativ për vitin 2024. Shuma 30.000 – 100.000 Euro i referohet vlerës së financimit që organizata mund të përfitojë për 2 vite nga Granti Themelor. Vlera e financimit për secilën nga organizatat përfutuese për të përcaktuar nga rezultatet e vlerësimit dhe nga kapacitetet përthithëse të organizatës.

Pyetja 14: Sa është numri i organizatave që pritet të mbështeten në këtë thirrje?

Në këtë thirrje për aplikim për Shqipërinë do të mbështeten me Grant Themelor minimalisht 3 organizata.

Pyetja 15: Është e rëndësishme që organizata të jetë e përfshirë në projekte në lidhje me Ballkanin Perëndimor?

Përvoja e organizatave në projekte rajonale nuk është një kriter skualifikues në këtë thirrje për aplikime. Lidhur me kriteret e vlerësimit ju lutem referojuni Seksionit “Kriteret e vlerësimit” në

Shtojca 1 – Udhëzimet për aplikim për Grante Themelore.

Pyetja 16: Mund të gjejmë ndonjë model nga aplikimet e viteve të kaluara që t’i referohemi buxhetit si duhet për këtë aplikim?

I gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga organizatat gjatë aplikimit të tyre në thirrjet publike të SMART Balkans është konfidencial dhe nuk mund të ndahet me asnjë palë të tretë, përveç ekspertëve të angazhuar në vlerësimin e aplikimeve. Ju lutemi referojuni **Shtojca 1 – Udhëzime për aplikim për Grante Themelore** për të marrë informacionin e nevojshëm mbi dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.

Pyetja 17: Një organizatë lokale që e shtrine veprimtarinë në 7-te Bashkitë e Qarkut Elbasan dhe me gjere, pyetja është a mund të aplikojmë vetëm, apo është kusht bashkëpunimi me organizata të tjera lokale apo kombëtare?

Organizatat duhet të aplikojnë individualisht dhe nuk partneritet apo bashkëpunim me organizata të tjera.

Pyetja 18: Organizata është aktualisht është duke zbatuar një Projekt Rajonal me financim të SMART Balkans, a penalizohemi nga ky fakt për të aplikuar në thirrjen e hapur?

Ju lutemi referojuni përgjigjes së pyetjes 1.

Pyetja 19: A kërkohen letra reference nga institucione publike vendore apo rajonale?

Jo, nuk kërkohen letra reference për këtë aplikim.

Pyetja 20: Në formatin e buxhetit thuhet pesë zërat kryesorë të buxhetit (1-5) nuk duhen ndryshuar. Nuk duhen ndryshuar si kategori apo si nenkategori pasi psh në qera nuk kemi?

Kategoritë e buxhetit nuk duhet të ndryshojnë, por nën-kategoritë mund të ndryshojnë dhe përshtaten sipas shpenzimeve që ka organizata,

Pyetja 21: Në udhëzime thuhet se buxheti operativ përfshin të gjitha kostot që ka organizata, duke përfshirë edhe kostot e pritshme që do të mbështeten nga projekti SMART Balkans. Buxheti do të paraqitet me kostot që ka organizata aktualisht për të gjitha projektet përfshirë edhe projektin SMART apo vetëm me projektin SMART?

Buxheti që do të dorëzohet përfshin të gjitha shpenzimet e pritshme të organizatës për vitin 2024.

Pyetja 20: Sa është përqindja e lejuar e kostove të administrimit?

Projekti SMART Balkans nuk ka përqindje të caktuara për linjat buxhetore, përfshirë këtu edhe kostot e administrimit.

Pyetja 21: Nëse organizata ka qene e regjistruar fillimisht në gjykatë si degë e një organizate të huaj dhe më pas është regjistruar në gjykatë si organizatë lokale, data e regjistrimit të parë të organizatës nënkupton atë të regjistrimit si organizatë lokale?

Data e regjistrimit të organizatës do të konsiderohet data e regjistrimit të saj si një organizatë lokale dhe jo data e data e regjistrimit fillestar si degë e një organizate ndërkombëtare.

Pyetja 22: Nëse një organizatë ka ekzistuar në formë projekti për 4 vite, pra që nga 2019 (me aktivitete të plota dhe krijim të strukturave si Bord dhe rrjet) dhe tani në 2023 ka marrë rregjistrimin në gjykatë si entitet me vetë, a lejohet të aplikojë për core grants?

Organizata duhet të ketë një përvojë 3 vjeçare nga momenti i regjistrimit të saj sipas legjislacionit në fuqi dhe një organizatë e regjistruar në vitin 2023 nuk mund të aplikojë në këtë thirrje publike për aplikim.